

AKT NORMATIV
Nr. 7, datë 18.3.2022

**PËR TRANSPARENCËN DHE MONITORIMIN E ÇMIMIT PËR DISA
PRODUKTE USHQIMORE BAZË DHE PRODUKTE TË TJERA TË LIDHURA ME
TO, SI PASOJË E SITUATËS SË VEÇANTË TË KRIJUAR NË TREG**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij akti normativ është përcaktimi i rregullave për transparencën dhe monitorimin e çmimit të disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg, në zbatim të pikës 3, të nenit 11, dhe të pikës 1, të nenit 17, të Kushtetutës.

Neni 2
Situata e veçantë

1. Situatë e veçantë, në kuptim të këtij akti normativ, janë të gjitha ato raste, të cilat krijojnë situatë emergjente kur tregu i disa produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, sipas listës së përcaktuar nga Bordi, karakterizohet nga:

- a) rritja e ndjeshme e çmimit të tyre në treg;
- b) ulja në mënyrë të ndjeshme e importeve mesatare të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të lidhura me to, në krahasim me importet mesatare mujore të vitit kalendarik pararendës, për shkak të mungesave në tregun ndërkombëtar;
- c) mungesa e produkteve në mënyrë të argumentuar në një shkallë të tillë, që pasojat e pafavorshme të shkaktuara nga kjo situatë nuk mund të shmangen a të parandalohen pa përcaktimin e masave, në përputhje me këtë akt normativ;
- ç) çdo situatë tjetër e krijuar në tregun ndërkombëtar, e cila ka sjellë deformime në tregun vendas.

2. Situata e veçantë shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 3
**Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë
të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to**

1. Me shpalljen e situatës së veçantë ngrihet dhe funksionon Bordi i Transparencës dhe Monitorimit të Çmimeve të Tregtimit me Shumicë/Pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, në vijim, Bordi.

2. Bordi ka në përbërje:

- a) ministrin përgjegjës për financat dhe ekonominë në cilësinë e kryetarit;
 - b) ministrin përgjegjës për bujqësinë;
 - c) drejtorin e përgjithshëm të Tatimeve;
 - ç) drejtorin e përgjithshëm të Doganave;
 - d) drejtorin e përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
 - dh) 6 (gjashtë) përfaqësues nga shoqëritë e tregtimit të produkteve;
 - e) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, në nivel drejtuesi të lartë;
 - ë) 1 (një) përfaqësues nga ministria përgjegjëse për bujqësinë, në nivel drejtuesi të lartë.
3. Bordi mund të ftojë të marrin pjesë në mbledhjet e tij edhe përfaqësues të tjerë nga institucione shtetërore, ekspertë të fushës apo grupe interesi.

4. Bordi merr vendime me shumicë të thjeshtë të të gjithë anëtarëve të tij. Në rastet e konfliktit të interesit të përfaqësuesve të shoqërive, ndaj të cilave merret masë administrative, përfaqësuesi merr pjesë pa të drejtë vote në mbledhjen e Bordit dhe përjashtohet nga vendimmarrja.

5. Sekretariati i Bordit përbëhet nga struktura përgjegjëse për politikën ekonomike dhe fiskale, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, dhe përfaqësues nga strukturat e administratës doganore.

6 (gjashtë) përfaqësuesit e subjekteve të përzgjedhura nga shoqatat e biznesit dhe grupet e interesit, dërgojnë emrat e përfaqësuesve të tyre te sekretariati i Bordit.

7. Mbledhjet e Bordit thirren me kërkesë të kryetarit të Bordit. Njoftimi për mbledhje duhet të kryhet të paktën 2 (dy) orë para mbledhjes.

8. Mbledhjet e Bordit, në cilësinë e organit kolegjal gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së situatës së veçantë, realizohen edhe *on-line*, nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik/telepunës.

Neni 4

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Bordit

Bordi ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

a) të miratojë listën e produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to, për të cilat zbatohet situata e veçantë;

b) të zbatojë metodologjinë e përcaktuar për vendosjen me transparencë të plotë të marzhit të fitimit;

c) të vendosë marzhin e fitimit në bazë të monitorimit të çmimeve për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to, si pasojë e situatës së veçantë të krijuar në treg;

ç) të njoftojë në mënyrë periodike, sipas vendimeve të Bordit, marzhin e fitimit, të cilat publikohen në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe në një seksion të veçantë në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për ekonominë dhe bujqësinë. Vendimet e marra nga Bordi i fillojnë efektet ditën pasardhëse ose sipas përcaktimit të vendimit të Bordit;

d) t'i propozojë strukturës përgjegjëse marrjen e masave administrative, sipas shkronjës "c", të nenit 7, dhe pikës 3, të nenit 8, të këtij akti normativ, që duhet të ndërmerren ndaj subjekteve në rast shkeljeje të parashikimeve të këtij akti normativ;

dh) çdo kompetencë tjetër që vlerësohet e nevojshme, në bazë të këtij akti normativ.

Neni 5

Strukturat për monitorimin e zbatimit të vendimeve të Bordit

Marzhi i fitimit i vendosur nga Bordi është i detyrueshëm të zbatohet nga të gjitha subjektet dhe zbatimi i tyre monitorohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet verifikimit të faturave të lëshuara nga subjektet gjatë periudhës së situatës së veçantë të krijuar në treg. Sipas rastit, Bordi mund të vendosë krijimin e një task-force, me përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Neni 6

Vlera e produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të tjera të lidhura me to

1. Bordi çdo javë monitoron vlerën e çmimit të produkteve, sipas listës së miratuar prej tij, dhe vendos marzhin e fitimit.

2. Vlera e çmimit përbëhet:

a) nga çmimi i dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, sipas origjinës së produkteve;

b) nga marzhi i fitimit të përcaktuar nga Bordi, për subjektet e importit dhe prodhimit, mbi çmimin e përlllogaritur sipas shkronjës "a", të kësaj pike, në të cilin aplikohen edhe taksat e tarifave, sipas legjislacionit në fuqi;

c) ndërsa për subjektet e tregtimit me pakicë, nga marzhi i fitimit i përcaktuar nga Bordi, mbi çmimin e përlllogaritur, sipas shkronjave "a", dhe "b", të kësaj pike, në të cilin aplikohen edhe taksat e tarifave, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 7

Masat e veçanta administrative

Në rast të mosrespektimit të marzhit të fitimit të vendosur nga Bordi për produktet ushqimore bazë dhe produktet e tjera të lidhura me to zbatohen sanksionet e mëposhtme:

- a) Subjektet e tregimit me shumicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të lidhura me to dënohen me gjobë, në masën 10 (dhjetë) milionë lekë;
- b) Subjektet e tregimit me pakicë të produkteve ushqimore bazë dhe produkteve të lidhura me to dënohen me gjobë, në masën 2 (dy) milionë lekë;
- c) Në rast përsëritjeje, masave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, i shtohet edhe pezullimi i ushtrimit të aktivitetit dhe sekuestrimi i produkteve në gjendje inventari.

Neni 8

Masat me karakter detyrues

1. Të gjitha subjektet, që importojnë dhe/ose prodhojnë produkte, objekt i këtij akti normativ, janë të detyruara të marrin masa dhe të ofrojnë furnizim të pandërprerë, në përputhje me vendimet e Bordit.

2. Të gjitha subjektet që tregtojnë produkte me shumicë, objekt i këtij akti normativ, të nevojshme për furnizimin e popullatës, janë të detyruara të marrin masa për mbajtjen e rezervave që tregtojnë, për një periudhë 3-mujore ose në përputhje me jetëgjatësinë e produktit, me qëllim përballimin e situatës së veçantë të krijuar në treg. Produktet e blera, me qëllim furnizimin e popullatës, në rastet kur me përfundimin e situatës së veçantë të krijuar në treg, nuk janë shitur në tregun e lirë, mund t'i shiten Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, me kërkesë të subjektit dhe sipas faturës me të cilën këto produkte janë blerë. Rregullat dhe procedurat për blerjen e këtyre produkteve nga Drejtoria e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për financat dhe ministrit të Mbrotjtjes.

3. Mosmarrja e masave nga subjektet private, sipas përcaktimeve të pikave 1 dhe 2, të këtij neni, dënohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të nenit 7, të këtij akti normativ, dhe këto subjekte përjashtohen nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 3-vjeçare nga Agjencia e Prokurimit Publik.

4. Të gjitha institucionet shtetërore, që do të zhvillojnë procedura prokurimi për produktet e miratuara me vendim Bordi, duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e këtij akti normativ, gjatë gjithë kohëzgjatjes së situatës së veçantë.

Neni 9

Organet kompetente për dhënien e masave administrative

1. Të drejtën e dhënies së masave administrative me gjobë, sipas përcaktimeve të nenit 7, të këtij akti normativ, e ka Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shkeljet e konstatuara, që lidhen me masat administrative me gjobë, sipas përcaktimit të nenit 7, të këtij akti normativ, vepron me dhënien e masës përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve nga data e konstatimit të shkeljeve.

3. Shkeljet e konstatuara nga Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, që lidhen me masën administrative me gjobë, sipas përcaktimit të nenit 7, të këtij akti normativ, i dërgohen brenda 24 (njëzet e katër) orëve Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila vepron brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e kërkesës, me dhënien e masës përkatëse të propozuar.

4. Shkeljet e konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, që lidhen me masën administrative “pezullim aktiviteti dhe sekuestrim të produkteve gjendje inventari”, i dërgohen brenda 48 (dyzet e tetë) orëve Bordit. Me marrjen e kërkesës, Bordi merr vendim lidhur me masën administrative “pezullim aktiviteti dhe sekuestrim të produkteve gjendje inventari”. Vendimi i Bordit i dërgohet për ekzekutim dhe fillimin e procedurës për pezullim aktiviteti Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe administratës tatimore për sekuestrimin e produkteve në gjendje inventari. Akti administrativ i

pezullimit të aktivitetit dhe sekuestrimit të produkteve gjendje inventari merret nga organi kompetent brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e konstatimit të shkeljes.

5. Gjobat e dhëna, sipas këtij akti normativ, përbëjnë titull ekzekutiv. Modeli i tyre përcaktohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

6. Gjobat e mbledhura, sipas këtij akti normativ, derdhen 100% në buxhetin e shtetit.

7. Shqyrtimi dhe dhënia e masave administrative bëhen në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 10

Kohëzgjatja dhe zbatimi

1. Parashikimet e këtij akti normativ zbatohen për atë kohë sa zgjat periudha e situatës së veçantë të krijuar në treg.

2. Zbatimi i parashikimeve të këtij akti normativ fillon me shpalljen e situatës së veçantë, me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfundimi i situatës së veçantë përcaktohet me vendim të Bordit.

3. Në çdo rast, ky akt normativ nuk përjashton aplikimin e legjislacionit në fuqi për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive apo akteve të tjera ligjore, për atë kohë sa nuk janë në kundërshtim me dispozitat e këtij akti normativ.

Neni 11

Ankimi ndaj masave administrative

Masat administrative me gjobë, të vendosura sipas këtij akti normativ, ankimohen sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative, ndërsa masat administrative me pezullim aktiviteti dhe sekuestrim të produkteve gjendje inventari ankimohen në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 12

Dispozitë kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij akti normativ shpallet edhe situata e veçantë, në kuptim të nenit 2, të këtij akti normativ, dhe fillojnë të zbatohen të gjitha dispozitat e këtij akti normativ.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 48, datë 30.03.2022